



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 1 Mars 2022

Nr: 25

V E N D I M

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 18, DATË 15.2.2022, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR RREGULLAT PROCEDURALE PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT (PEVN) NË QENDRAT E VOTIMIT TË BASHKISË VORË, QARKU TIRANË, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022"**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "ç", 77, 78, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85 dhe 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 18, datë 15.2.2022, të Komisionit Rregullator "Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në qendrat e votimit të bashkisë Vorë, qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022", bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

- a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. KQZ-ja i dorëzon KZAZ-së materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18, të vendimit nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit", i ndryshuar."

- b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“5. KZAZ-ja i dorëzon KQV-së materialet zgjedhore si dhe procesverbalet e dokumentacionin e punës të përshtatur për këtë bashki.”.

c) Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. KQZ-ja i dorëzon KQV-ve PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin dhe numërimin elektronik.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Iirjana NANO**                      **Kryetar**

**Arens ÇELA**                      **Anëtar**

**Dritan ÇAKA**                      **Anëtar**

**Helga VUKAJ**                      **Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**                      **Anëtar**

